



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost
Kosovo Academy for Public Safety

Bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, **Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), shpall këtë:**

KONKURS

Titulli i vendit të punës: **Udhëheqës i Zyrës për Vlerësim të Cilësisë dhe Kualitetit,**

Kategoria dhe grada e vendit të punës: **Nivel drejtues, koeficienti 9**

Nr. i ref : **AKSP-4/2012,**

Raporton të: **Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-së,**

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore,

1. Zbaton procedurat të cilat përfshijnë të gjitha proceset e sigurimit të cilësisë dhe kualitetit,
2. Mbikëqyr dhe ndihmon në përmirësimin e vazhdueshëm të të gjitha proceseve të kontrollit të cilësisë përmes metodave, veprimeve të drejta dhe të përshtatshme,
3. Bën rregullisht rishikimin e efikasitetit të vet sistemit të cilësisë,
4. Është përgjegjës për mirëmbajtjen e të dhënave dhe ruajtjen e tyre në të shtypur si dhe në formën elektronike,
5. Bën verifikimin gjithëpërfshirës të kërkesave të sigurisë së cilësisë të zbatueshme të programet studimore, verifikimin se a janë proceset të përshtatshme për t'i arritur objektivat, apo se a i përfshijnë elementet e kontrollit sistematik të cilësisë si dhe të përmirësimit të cilësisë,
6. Vlerëson programet studimore në mënyrën më të përshtatshme duke u bazuar në katër hapat e ciklit të kontrollit të cilësisë si: Objektivi - definimi i objektivave të vlefshëm, Koncepti, Implementimi dhe Sigurimi i cilësisë - monitorimi i cilësisë si dhe rishikimi i objektivave,

7. Bashkëpunon me të gjithë aktorët e Akademisë, anëtarët profesionalë si dhe studentët në të gjitha fazat e veprimit për implementimin e sistemit të sigurimit dhe kontrollit të cilësisë si dhe është përgjegjëse për sistemin e sigurisë së cilësisë e që përfshin po ashtu edhe dizajnimin e të gjitha veçorive të sistemit,
8. Kryen edhe detyra tjera në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm e që kërkohen kohë pas kohe nga Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-së.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim

Në shërbimin civil kanë te drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave që kërkohen për pozitën përkatëse.

Procedura e konkurimit

Për pozitën e Udhëheqësit të Zyrës për Vlerësim të Cilësisë dhe Kualitetit, procedura e konkurimit është brendshme (vetëm për nëpunësit civil ekzistues të AKSP-së).

Shkollimi i kërkuar

- Përgatitje Universitare-shkencat shoqërore (e obligueshme).

Aftësia, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen

Njohuri të mira të punës me kompjuter, me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Power Point), fleksibilitet dhe aftësi për të punuar nën presion dhe brenda afateve të kufizuara kohore, aftësi për të punuar me njerëz të kulturave dhe religjioneve të ndryshme, gjinisë dhe pikëpamjeve të ndryshme politike duke ruajtur paanshmërinë dhe objektivitetin, vet-iniciativë dhe përkushtim i vëmendjes ndaj detaleve dhe aftësi për të punuar në një ambient ekipor e nevojshme. Së paku tre (3) vjet përvojë pune në fushën përkatëse (e nevojshme). Njohja e njërës nga gjuhët zyrtare (e obligueshme). Njohja e gjuhës angleze (përparësi).

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin

Përzgjedhja e Udhëheqësit të Zyrës për Vlerësim të Cilësisë dhe Kualitetit, bëhet në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, si dhe Rregulloren Nr.07/2010 për Emërimin e Nëpunësve Civil.

Kohëzgjatja e emërimit

Për pozitën e Udhëheqësit të Zyrës për Vlerësim të Cilësisë dhe Kualitetit, emërimi është me kohë të pacaktuar (karrierës).

Data e mbylljes se konkursit

Konkursi është i hapur 7 ditë kalendarike nga data e publikimit, duke filluar nga data 18.04.2012 deri me datën 24.04.2012.

Paraqitja e kërkesave

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), Zyra e Personelit, dhoma nr.1. kati I, ndërtesa e re administrative Vushtrri, ose nëpërmjet adresës elektronike në linkun: <http://aksp.rks-gov.net/>. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohet për vendin e punës për të cilin konkurroni.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”.

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen

Për informata me te hollësishme mund te kontaktoni Zyrën e Personelit nr. tel: 028 570 008 Ext 114 ose 233, prej orës 08:00 - 1600.